



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIVJAKË  
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 5124 / 29

Divjakë më / 28/12 /2021

VENDIM

Nr 61 datë 28/12/2021

**“Mbi Miratimin e Planit të Aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Divjakë për vitin 2022.”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, të nenit 51, pika 3, nenit 54 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar dhe në zbatim të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, Kreu VIII. Financimi i Aktiviteteve Të Këshillit, Neni 101 “Programi i Punës së Këshillit Bashkiak” dhe Projektvendimit të paraqitur nga Konferenca e Kryetarëve, Këshilli Bashkiak Divjakë, në mbledhjen e datës 28.12.2021

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Divjakë për periudhën Janar 2022 – Dhjetor 2022.
  - a) Planin e aktiviteteve të Këshillit Bashkisë për vitin 2022.
  - b) Planin e punës së Këshillit Bashkisë për vitin 2022.
  - c) Planin vjetortë konsultimeve publike për vitin 2022.Bashkangjitur është programi i çështjeve sipas muajve për vitin 2022.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak Divjakë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ana NAKO

